REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Nr.5562 Prot Maliq, më 21.10.2025

PROJEKT-VENDIM - NR 9

Për

Konfirmimin e inventarizimit në mënyrë të gabuar të pasurisë nr. 109/47, Zona Kadastrale 2984, fshati Plasë, në listën e inventarit të pronave të transferuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1154, datë 13.08.2008 "*Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pojan të Qarkut të Korçës*"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja "a" dhe "c", nenit 54 të Ligjit Nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*" i ndryshuar, nenit 34, pika 5 të Ligjit Nr. 20/2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", pikës 37 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 827, datë 30.09.2020 "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë, të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të ndërtimeve në përdorim*", si dhe Shkresës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë-Devoll-Kolonjë nr. 3002/9 prot., datë 19.09.2025 "*Kërkesë për informacion, konfirmim*",

PROPOZOJMË:

1. Konfirmimin e inventarizimit në mënyrë të gabuar të pasurisë nr. 109/47, Zona Kadastrale 2984, fshati Plasë, në numrin rendor 54, të listës së inventarit të pronave të transferuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1154, datë 13.08.2008 "*Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pojan të Qarkut të Korçës*".
2. Pasuria nr. 109/47, Zona Kadastrale 2984, fshati Plasë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme publike të Bashkisë Maliq.
3. Ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve pranë Bashkisë Maliq për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Konceptoi: N. Çaushi Dt. 17/10/2025

Topograf/Kadastër: M. Lame Dt. 17/10/2025

Drejtor D.P.P.A: J. Sulo Dt. 17/10/2025

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Nr.5562 Prot Maliq, më 21.10.2025

Lënda: Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin "*Për konfirmimin e inventarizimit në mënyrë të gabuar të pasurisë nr. 109/47, Zona Kadastrale 2984, fshati Plasë, në listën e inventarit të pronave të transferuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1154, datë 13.08.2008 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pojan të Qarkut të Korçës"*

Drejtuar: **Këshillit të Bashkisë Maliq**

Të nderuar Këshilltarë,

Projekt-Vendimi "*Për konfirmimin e inventarizimit në mënyrë të gabuar të pasurisë nr. 109/47, Zona Kadastrale 2984, fshati Plasë, në listën e inventarit të pronave të transferuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1154, datë 13.08.2008 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pojan të Qarkut të Korçës"*, mbështetet në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja "a" dhe "c", nenin 54 të Ligjit Nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*" i ndryshuar, nenit 34, pika 5 të Ligjit Nr. 20/2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", pikës 37 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 827, datë 30.09.2020 "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë, të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim*", si dhe shkresës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë-Devoll-Kolonjë nr. 3002/9 prot., datë 19.09.2025 "*Kërkesë për informacion, konfirmim*".

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, me shkresë nr. 3002/2 prot., datë 10.06.2025 "*Kërkesë për informacion*", protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr. 3167 prot., datë 12.06.2025, ka kërkuar informacion nëse objekti pa titull pronësie dhe trualli funksional me numër pasurie **109/47**, në Zonën Kadastrale 2984, fshati Plasë, me posedues **Bujar Ramadan Hoxhalli**, është ndërtuar apo jo para datës 10.08.1991, cili është funksioni i ndërtesës sot, dhe a figuron në inventarin e pasurive në pronësi të Bashkisë Maliq, pasuria e sipërcituar.

Duke marrë shkas nga praktikat e dërguara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, Kryetari i Bashkisë me Urdhër nr. 103, datë 19.02.2024 "*Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e gjëndjes në fakt, të pasurive të paluajtshme private të ndërtuara deri në datën 10.08.1991, pjesë e territorit administrativ të Bashkisë Maliq*", ka ngritur grupin e punës, i cili ka për detyrë të verifikojë çdo praktikë që paraqitet me shkresë zyrtare nga ASHK, të hartojë proces-verbalin e evidentimit në fakt të objektit, pronë private, duke cilësuar nëse është ndërtim para ose pas datës 10.08.1991, dhe se çfarë funksioni ka objekti.

Bazuar në shkresën e mësipërme të ASHK, grupi i punës i ngritur me Urdhër nr. 103, datë 19.02.2024, ka verifikuar në terren objektet pa titull pronësie, me posedues Bujar Ramadan Hoxhalli, dhe ka mbajtur proces-verbalin e verifikimit. Nga verifikimi i kryer ka rezultuar se objekti ***është ndërtim përpara datës 10.08.1991, me funksion banimi.***

Ndërkohë që nga Sektori i Pronave Publike dhe Aseteve pranë Bashkisë Maliq është kryer verifikimi i pasurisë nr. 109/47, dhe ka rezultuar se: nga verifikimi paraprak i listës së inventarit të pasurive të paluajtshme shtetërore publike, referuar VKM-së *nr. 1154, datë 13.08.2008 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pojan të Qarkut të Korçës"*, pasuria nr. 109/47, Zk 2984, fshati Plasë, **rezulton e transferuar në "Pronësi"** të Bashkisë Maliq, në fletën e inventarit me **nr. rendor 54**, e pasqyruar si vendstrehim.

Bazuar në proces-verbalin e verifikimit të mbajtur nga grupi i punës me Urdhër nr. 103, datë 19.02.2024, dhe verifikimin e listës së inventarit të pronave te transferuara me VKM nr. 1154, datë 13.08.2008, nga ana e Bashkisë Maliq i është kthyer përgjigje ASHK me shkresë nr. 3167/1 prot., datë 07.07.2025.

Në vijim ASHK-Korçë me shkresën nr. 3002/8 prot., datë 06.08.2025 "*Kërkesë për dorëzim dokumentacioni*", na kërkon: pasqyrimin hartografik të vendndodhjes së vendstrehimit në raport me ndërtimin (banesën) e poseduar nga Bujar Hoxhalli.

Bazuar në shkresën e mësipërme të ASHK, specialistë nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve pranë Bashkisë Maliq, kanë verifikuar në terren dhe ka rezultuar se në pasurinë nr. 109/47, zk. 2984, nuk ka asnjë gjurmë objekti të llojit vendstrehim. Ky informacion i është dërguar ASHK-së me shkresë nr. 3167/3 prot., datë 16.09.2025.

Ndodhur në këto kushte ASHK, në respektim të pikës 37 e në vazhdim të VKM-së nr. 827, datë 30.09.2020, ka kërkuar nga ana e Këshillit të Bashkisë Maliq, konfirmimin me vendim përkatës nëse inventarizimi i pasurive nr. 109/47 në listën e pronave në pronësi të Bashkisë Maliq, **është i gabuar** apo i saktë.

Ndodhur në këto kushte, kur nga verifikimi i kryer nga Grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.103 datë 19.02.2024, u konstatua se:

- ***Objekti me posedues Bujar Ramadan Hoxhalli, me nr. pasurie 109/47, zk. 2984, fshati Plasë, është ndërtim i ngritur para vitit 1991, me funksion banimi;***

dhe përballë faktit se në pasurinë nr. 109/47, nga verifikimi i kryer ka rezultuar se nuk ka asnjë gjurmë të objektit të llojit "vendstrehim", kërkojmë të vazhdohet sipas procedurës së përcaktuar nga pika 37 e VKM-së nr. 827, datë 30.09.2020, i cili përcakton se: ***"Nëse gjatë procedurave administrative konstatohet se objekti pa titull është inventarizuar/transferuar si pronë shtetërore në mënyrë të gabuar, me marrjen e konfirmimit shkresor nga institucionit qëndror ose këshilli i vetëqeverisjes vendore, drejtoria vendore miraton dokumentin e pronësisë sipas këtij kreu, në përputhje me pikën 5, të nenit 34, të ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".***

Për sa më sipër në kompetencën Tuaj, kërkojmë miratimin e këtij projekt-vendimi, mbi konfirmimin e inventarizimit në mënyrë të gabuar të pasurisë nr. 109/47, Zona Kadastrale 2984, fshati Plasë, në numrin rendor 54, të listës së inventarit të pronave të transferuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1154, datë 13.08.2008 "*Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pojan të Qarkut të Korçës*".

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj!

Konceptoi: N. Çaushi Dt. 17 / 10 /2025

Topograf/Kadastër: M. Lame Dt. 17 / 10 /2025

Drejtor D.P.P.A: J. Sulo Dt. 17 / 10 /2025

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 3167/1 Prot

Maliq, më 7.7.2025

Lënda: **Dërgim informacioni**

Drejtuar: **AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS**
DREJTORIA VENDORE KORÇË -DEVOLL - KOLONJË

Në përgjigje të shkresës Nr.3002/2 Prot.,datë 10.06.2025 me lëndë "Kërkesë për informacion", protokolluar pranë Bashkisë Maliq me Nr.3167 Prot.,datë 12.06.2025, për objektin me aplikues Z.Bujar Ramadan Hoxhalli (si në fragmentin hartografik paraqitur) Nr.Pasurie 109/47, ZK.2984 fshati Plasë, Njësia Administrative Pojan , Bashkia Maliq ju informojmë si më poshtë.

Grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.103 datë 19.02.2024 gjatë verifikimit në teren konstatoi se:

1. Objekti është ndërtim para datës 10.08.1991.
2. Funksioni i ndërtesës në momentin e verifikimit në teren është banesë.
3. Nga verifikimi paraprak i listës së inventarit të pasurive të paluajtshme shtetërore publike, referuar VKM nr. 1154, datë 13.08.2008 "*Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pojan të Qarkut të Korçës*", pasuria nr. 109/47 e llojit "ndërtesë", ZK. 2984, fshati Plasë, rezulton e transferuar në "pronësi" të Bashkisë Maliq, në fletën e inventarit të pronës me numër rendor 54.
   Bashkëlidhur ju dërgojmë VKM nr. 1154, datë 13.08.2008, së bashku me fletën e inventarit me numër rendor 54.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi :	S.FEJZOLLI		Dt. 07.07.2025
P.Sektori	N.ÇAUSHI		Dt. 07.07.2025 Nr. _____Prot.
P. Sektori	R.SPAHO		Dt. 07.07.2025
Drejtor DPKZHT:	E. JONUSLLARI		Dt. 07.07.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

BASHKIA MA
Zyra e Protok...
Nr. 3167 Prot.
Data 12.06.25 Nënshkrimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE KORÇË-DEVOLL-KOLONJË

Nr. 3002/2 Prot. Datë 10/06/2025

Lënda: Kërkesë për informacion.

BASHKISË MALIQ

NJËSISË ADMINISTRATIVE POJAN

Të nderuar!

Pranë Drejtorisë Vendore të ASHK Korçë në zbatim të Vendimit Nr. 827, datë 30.09.2020 "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim* " ka paraqitur aplikim subjekti:

Bujar Ramadan Hoxhalli, për objektin pa titull pronësie dhe truallin funksional të ndodhur në ZK. 2984, (Plase), Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq, me nr pasurie **109/47.**

Në zbatim të Ligjit 90/2012 „ Për *organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore* " ,VKM-së Nr.867,datë 10.12.2014 "*Për proçedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore*" dhe VKM –së Nr. 827, datë 30.09.2020 "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim*" , duke qënë që subjekti i sipërcituar pretendon se objekti që ai posedon përkatësisht, t'a ketë ndërtuar para datës 10.08.1991 kërkojmë të na vini në dispozicion informacionin si më poshtë:

- **Nëse objekti i ndodhur në Zonën Kadastrale të sipërpërmendur, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq është ndërtuar apo jo para datës 10.08.1991?**
- **Cili është funksioni i ndërtesës sot?**
- **A figuron në inventarin e pasurive në pronësinë e Bashkisë Maliq, pasuria e sipërcituar?**

Ju kujtojmë se: Informacioni i kërkuar shërben për të vazhduar proçedurat administrative në zbatim të ligjit Nr. 20/2020 „ *Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë* „

Rr "1 Maji", Lgj. 18, Korçë
http:// www.ashk.gov.al
Tel: +355 82244642
Faks: +3558224464

duke qënë i domosdoshëm për vazhdimin e proçedurave ligjore të kalimit të pronësisë e të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe truallit funksional të tyre. Si rrjedhim, duhet të ná vihet në dispozicion **brenda afatit ligjor nga administrimi** i kësaj shkrese.

Bashkangjitur po ju veme ne dispozicion siperfaqen e konturuar te pasurise.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTORI
Eni Polena

Eni Polena

Digitally signed by Eni Polena
Date: 2025.06.09 11:54:11 +02'00'
Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore KORÇË-DEVOLL-KOLONJË
Date:2025/06/10 10:25:08 +02'00'
10@UKORCE-DEVOLL-KOLONJE20250610102502020l4

Rr. [illegible] 18, Korçë
http://www.shk.gov.al

Tel: +355 82244642
Faks: +3558224464

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore KORÇË-DEVOLL-KOLONJË)

BASHKIA MALIQ
Zyra e Protokollit
Nr. 3167/2 Prot.
Date. 11.7.25
Nj. Administrative Pojan

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE KORÇË-DEVOLL-KOLONJË

Nr. 3009/8 Prot. Datë 06/08/2025

Lënda: Kërkesë për dorezim dokumentacioni.

BASHKISË MALIQ

NJËSISË ADMINISTRATIVE POJAN

Per dijeni: Bujar Ramadan Hoxhalli

Fshati Plase, Njesia Administrative Pojan, Bashkia Maliq

Të nderuar!

Pranë Drejtorisë Vendore të ASHK Korçë-Devoll-Kolonje, në zbatim të Vendimit Nr. 827, datë 30.09.2020 "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim* " ka paraqitur aplikim subjekti **Bujar Ramadan Hoxhalli,** për objektin pa titull pronësie dhe truallin funksional të ndodhur në ZK. 2984, (Plase), Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq, me nr pasurie **109/47**.

Me shkresen tuaj nr 3167/1 prot, date 07.07.2025 konfirmuat faktin se brenda pasurise nr 109/47 **rezulton ne pronesine tuaj nje vendstrehim**, pasqyruar ne fleten e inventarit me numer 54, te VKM-se nr 1154, date 13.08.2008 " Per miratimin e listes paraprake te pronave te paluajtshme publike, shteterore, qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te Komunes Pojan te Qarkut te Korces".

Per sa me siper kerkojme nga ana juaj pasqyrimin hartografik te vendndodhjes se ketij vendstrehimi ne raport me ndertimin (banesen) ne menyre te tille qe siperfaqja funksionale e tij (zona buferike) te perjashtohet nga genplani jone, afishuar prane Institucionit tuaj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTORI
Eni Polena

Digitally signed by Eni Polena
Date: 2025.08.05
Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore KORÇË-DEVOLL-KOLONJË
Date: 2025/08/06 08:41:56 +02'00'
Reason: DRCE-DEVOLL-KOLONJE20250806084150010l4

Rr. [illegible], Korçë
http://www.[illegible].gov.al
Tel: +355 82244642
Faks: +3558224464

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore KORÇË-DEVOLL-KOLONJË)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE ASETEVE

Nr. 3167/3 Prot

Maliq, më 16.9.2025

Lënda: Kthim përgjigje

AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS
DREJTORISË VENDORE KORÇË-DEVOLL-KOLONJË
Adresa: "Rruga 1 Maji, Lagjja 18"
KORÇË

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 3002/8 prot., datë 06.08.2025, me lëndë "*Kërkesë për dorëzim dokumentacioni*", protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr. 3167/2 prot., datë 13.08.2025, ju informojmë si vijon:

Nga verifikimi i kryer në terren nga specialistët e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Aseteve pranë Bashkisë Maliq, në datën 10.09.2025, në pasurinë nr. 109/47, zk 2984, fshati Plasë, rezultoi se në këtë pasuri, nuk ka asnjë gjurmë të objektit vendstrehim.

Bashkëlidhur ju dërgojmë fotot e mbajtura gjatë verifikimit në terren.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj!

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ